



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e Bashkisë Divjakë dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV): 34330000-9 Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash, (CPV): 50112000-3 Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash, (CPV): 34300000-0 Pjesë dhe pajisje për automjetet dhe motorët e tyre.

VLERA E FONDIT LIMIT: 9 450 000 (nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa Tvsh dhe 11 340 000 (njëmbëdhjetë milion e treqind e dyzetë mijë) Lekë me Tvsh nga e cila:

- 1- **Spektori i Rrugëve Rurale** 166,666.67(njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa Tvsh dhe 200,000 (dyqind mijë) Lekë me Tvsh.
Programi 04520, Kapitulli 05 (të ardhurat), Llogaria ekonomike 602, Grupi (00), Kodi i projektit 9999999.
- 2- **Spektori Ujitje-Kullim** 745,833 (shtatëqind e dyzetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh dhe 895,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) Lekë me Tvsh.
Programi 04240, Kapitulli 01 (grant), Grupi (00), Llogaria ekonomike 602, Kodi i projektit 9999999.
- 3- **Bashkia** 8,204,166.67 (tetë milion e dyqind e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa Tvsh dhe 9,845,000 (nëntë milion e tetëqind e dyzetë e pesë mijë) Lekë me Tvsh.
**Programi 01110, Kapitulli 01 (grant); 4,166,666.67 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa Tvsh dhe 5,000,000 (pesë milion) Lekë me Tvsh.
Kapitulli 05 (të ardhurat); 4,037,500 (katër milion e tridhjetë e shtatë mijë pesëqind) Lekë pa Tvsh dhe 4,845,000 (katër milion e tetëqind e dyzetë e pesë mijë) Lekë me Tvsh, Grupi (00), Llogaria ekonomike 602, Kodi i projektit 9999999.**

- 4- **Sektori i Mzsh-së 333,333.33** (treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh dhe 400,000 (katërqind mijë) Lekë me Tvsh.

Programi 03280, Kapitulli 05, Grupi (00), Llogaria ekonomike 602, Kodi i projektit 9999999.

- 5- **Në bazë të Vendimit të Këshillit Nr. 5 datë 24.01.2025, fondi i Agjensisë së Shërbimeve Komunale është bashkuar me fondin e Bashkisë Divjakë.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, si edhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Divjakë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, Njësia e Prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, preventivin, si edhe në procesverbalin për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit, për tenderin me objekt: **“Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e Bashkisë Divjakë dhe Agjensisë së Shërbimeve Komunale”**, mbajtur nga komisioni për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim, të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Konkretisht Njësia e Prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar, është vënë për të patur një informacion sa më koherent, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve vendore. Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 8 dhe nenin 43 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar. Megjënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse, për vitin 2024 dhe kështu e maturuara të vitit 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, i ndryshuar dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përsa i perket aftësisë teknike e profesionale, vlerësojme si kritere teknike të nevojshme, për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kriteret si më poshtë:

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë ne pronesi ose me qira një servis. Për të vërtetuar pronësinë e servisit, operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë, dokumentacion që vërteton pronësinë (Certifikatë për vërtetim pronësie). Për kontrata të qirasë, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse të qirasë me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Për të vërtetuar pronësinë e servisit, operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë, dokumentacion që vërteton pronësinë (Certifikatë për vërtetim pronësie). Për kontrata të qirasë, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse të qirasë me objekt dhe afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, I ndryshuar dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si edhe në nenin 40, pika 5/ç të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pra, me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë, të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK-së, për të siguruar se ofertuesit do ta realizojnë me sukses kontratën, sipas kërkesave të përcaktuara në DST, pasi bën të mundur dhe garanton, përputhshmërinë dhe rregullsinë e procesit të furnizimit, cilësinë e produktit, si edhe disponibilitetin e mallit me cilësinë e kërkuar, përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarres, duhet të paraqesë një vertetim nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 5 (pesë) punonjës, shoqëruar me Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi (Formulari numer E-SIG 025/a), të disponuara dhe konfirmuara elektronikisht nga sistemi.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (Formulari numer E-SIG 025/a), të disponuara dhe konfirmuara elektronikisht nga sistemi, duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit)

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.* Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 5 (pesë) punonjës, është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh edhe riparim-shërbimet që do të kryhen me mjetet e paraqitura në preventiv. Referuar zërave të shërbimeve të kërkuara në preventiv, duket qartazi domosdoshmëria e punonjësve të cilët kanë aftësinë e duhur për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

3. Operatorët ekonomikë pjesëmarres, duhet të kenë në stafin e tyre jo më pak se 5 (pesë) punonjës, nga të cilët:

-1 punonjës mekanik, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit të mekanizmave, sistemeve të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

- 1 punonjës elektroaut, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit të impianteve elektrike të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

- 1 punonjës saldator, për kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit me saldim të mekanizmave, sistemeve të mjeteve të makinerisë së rënde dhe mjeteve të transportit të paraqitura në preventiv.

-1 punonjës xhenerik , per kryerjen e çmontimit – riparimit – montimit te pjeseve xhenerike te mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit te paraqitura ne preventiv.

-1 punonjës Ing.Mekanik , per te ndjekur kryerjen kryerjen e riparim-sherbimeve me cilesi te mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit te paraqitura ne preventiv.

Per permbushjen e ketij kriteri, Operatori ekonomik duhet te kete ne Listepagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi punonjesit e mesiperm, si edhe per secilin prej tyre duhet te paraqitet:

-Kontrata e punes, deshmite profesionale te leshuara nga institucione shteterore ose private te akredituara ne Republiken e Shqiperise, kjo per arsye se te gjitha riparim – sherbimet e mjeteve te makinerise se rende dhe mjeteve te transportit, kerkojne cilesi dhe specialiste perkates, me pervoje pune dhe besueshmeri ne kryerjen e riparim – sherbimit te kerkuar.

Autoriteti kontraktor përpara shpalljes së kualifikimit të operatoreve ekonomik ka të drejtën e verifikimit te informacioni te dhene nga operatori ofertues per plotesimin e ketij kriteri kualifikues.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1- Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të ketë ne pronesi ose me qira një servis, ku te disponoje, makineri e paisje te nevojshme per realizimin e kontrates si vijon:

-Makineri teknologjike si, torno me shtrat mbi 3 m per riparim eskavatori, trapano magnetike, radiale,bareno.

-Makineri për barrinim.

-Makineri për presim tubosh.

-Ratifik për ratifikim testatash dhe pjesë pompash dhe motorri.

-Të ketë vinç ure 10-12 ton.

*Për të gjitha paisjet e mësiperme, duhet te paraqiten foto.

- Operatori Ekonomik eshte i detyruar te kryej riparim – sherbimin dhe furnizimin me pjese këmbimi të eskavatorve dhe mjeteve te transportit.

- Shërbimi për ndërrimin dhe riparimin e pjesëve të dëmtuara ose me difekt etj, do të bëhet me pjese originale (ose ekuivalente me to) dhe jo me pjese te modifikuara, të riparuar ose të përdorura.

- Pajisjet dhe pjesët e dëmtuara pas ndërrimit, riparimit do të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Divjakë.

- Per te gjitha pjeset e nderrimit duhet te behet furnizimi me to sipas specifikimeve dhe llojit perkates te cdo mjeti dhe sjellja e tyre ne magazinën e Bashkise Divjake nga ana e Operatorit Ekonomik.

- Riparimet dhe sherbimet qe do te ofrohen nga operatori ekonomik, duhet te kene garanci jo me pak se 6-gjashte muaj.

- Cdo ofertues duhet te jape cmimet e riparimit dhe sherbimit detyrimisht per te gjitha zerat e tabelës se kryerjes se sherbimit.
- Afati i perfundimit te kontrates eshte **8 muaj nga nenshkrimi i kontrates.**
- **Ne rast te mosplotesimit te kohes se garancise nga cilesia e keqe e pjeseve te montuara ose punes jo te mire per montimin e tyre, perseritet riparimi duke filluar garancine qe nga ajo dite. Ne rastet e perseritjes se te njejtit defekt, apo defekteve te reja, qe mund te kene ardhur si rezultat e pasoje i riparimit te defektit me mangesi ose pjese te perdorura, riparimet do te kryhen nga Operatori Ekonomik pa pagese.**
- Kontrolli teknik i pajisjeve per sherbim qe do te kryhet do te behet nga perfaqesuesit e Drejtorise se Infrastruktures, e cila ben dhe miratimin e punimeve, sherbimeve qe do te kryhen, te pasqyruara ne nje situacion te firmosur nga te dyja palet dhe qe do shoqeroje faturen e fiskalizimit te kryerjes se sherbimit.
- Dokumentat do te jene te vulosura dhe pa korrigjim.
- Koha mesatare e riparimit te nje eskavatori do jete **10** dite pune dhe per nje mjet transporti do të jetë 7 ditë pune.
- Të gjitha pjeset e mesiperme te jene ne perputhje me kerkesat e katalogjeve te cdo ekskavatori dhe mjeti transporti.
- Gjate periudhes se garancise te mos kete rrjedhje apo renie te fuqise se punes se mjetit.
- Ne riparimet e nyjeve te mos kete ndryshime konstruktive qe ndikojne ne afatin e sherbimit.
- Pjeset e perdorura per riparimin e mjeteve te jene te tipit perkates, pas riparimit te mos kete defekte dhe zhurma jo normale.
- Riparimi i defekteve te paisjeve apo zevendesimi eshte detyrim i operatorit ekonomik qe merr persiper kryerjen e sherbimit. Te gjitha sherbimet per nderrimin e pjeseve te ndryshme do te zevendesohen me pjese origjinale ose ekuivalente me to.
- Kryerja e sherbimit, sidomos ato emergjente do te realizohet ne cdo kohe, sipas kerkeses se argumentuar te Autoritetit Kontraktor.
- Kryerja e sherbimit, riparimit, zevendesimi pjeseve etj, do te behet me mjetet e operatorit ekonomik, sipas kerkeses se argumentuar te perfaqesueseve te Drejtorise se Infrastruktures te Bashkise Divjake.
- Vendi dhe kryerja e sherbimeve: Ne objektet ku punojne mjetet dhe ne oficinen e kontraktorit, sipas nevojave te argumentuara per kryerjen e riparim – sherbimit te mjeteve.
- Vendi dhe dorezimi sherbimeve nga pala kontraktore do te jete ofcina e pales kontraktore ose vendi ku dote kryhet riparim – sherbimi i mjetit perkates.
- Dorezimi i sherbimeve dhe mallrave do te behet ne vendet e percaktuara si me sipër, ne prani te grupit te specialisteve te Drejtorise se Infrastruktures te Bashkise Divjake.

Shenim: Pjeset e kembimit dhe materialet e kerkuara duhet te jene kampione te njejte sipas katalogut te cdo mjeti.

2.3.4 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të disponoje certifikatat e meposhteme:

- Certifikat për sistemin e menaxhimit të cilësise ISO 9001:2015.
- Certifikat për sistemin e menaxhimit të sigurise dhe shëndetit në pune ISO 45001:2018/ Ose ISO 45001:2023 e perditeluar
- Certifikat për sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015
- Certifikat të paisjeve nën presion.

Paisja me certifikatat e mesiperme , bene te mundur qe ne kryerjen e riparim-sherbimeve te kerkuara te kemi nje besueshmeri me te larte ne raport me menaxhimin e cilesise ,me menaxhimin e sigurise dhe te mbrojtjes ne pune si dhe ne raport me menaxhimin dhe ruajtjen e mjedisit.

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga anetaret e bashkimit te operatoreve se bashku)

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”** i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 **“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”** i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,, si edhe ne Ligjin nr.116/2014 **“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e shqipërisë”**, ku përcaktohet se Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues, i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për realizuar me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri, kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Ne lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me te, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas

standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet të paraqesin ato. Pra, për vetë natyrën e veçantë, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, për sa kohë do të pranohen dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre, për përmbushjen e plotë të kontratës. Kjo kërkesë, është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, si edhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Për sa më sipër, pajisja me këto certifikata ISO, garanton AK që OE konkurues, plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm. Pa certifikat paisjet nën presion nuk lejohen të perdoren ligjërisht dhe perbejnë rrezik për jetën dhe pronën.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialisti i fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT